



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK

TEPELENE

Nr 1896/ Prot

Tepelene me 23.12. 2019



Nr 78 Date 28.12 2019

Disa ndryshime ne VKB Nr 74 date 28.12.2018

**"PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE"**

Mbështetur në gërmën "f", të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Në ligjin 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore " në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar me Ligj Nr. 95/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për Sistemin Taksave Vendore", të ndryshuar; Në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin Nr. 24/2017 "Për Administrimin Ujitjesdhetë Kullimit", Ligjin 9385 datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar; neni 15 i Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor" (i ndryshuar); neni 32, pikat 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 22 AKEP, datë 24.06.2011 "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike" (e ndryshuar); neni 10, pika 3 e neni 12 i ligjit 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" **Vendimi i Keshillit Bashkiak nr 78 date 31.10.2019 'Per miratimin e planit vendor per menaxhimin e mbetjeve urbane ne Bashkisne Tepelene** Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

**VENDOSI:**

1. Te miratoj tarifat vendore si me poshte ;

## B. TARIFAT VENDORE

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Tepelene dhe Njësive të saj Administrative.

Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet

| Nr  | Kategoritë               | Niveli i tarifës  |
|-----|--------------------------|-------------------|
| I   | FAMILJARET (për familje) |                   |
| I.1 | Njesia Administ Tepelenë | 1,000 leke me vit |
| I.2 | Njësitë e tjera adminst. |                   |
|     | Qendër Tepelenë          | 500 leke ne vit   |
|     | Kurvelesh                | 500 leke ne vit   |
|     | Lopes                    | 0                 |

Tabelë Tarifë pastrimi për institucione

| II      | Tarifë pastrimi për institucione                                                         | Njësia         | Tarifa        |
|---------|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| II.1    | Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj. | lekë/vit/njësi | 12,000        |
| III     | BISNESI                                                                                  | Bisnes i vogël | Bisnes i madh |
| III.1   | Njësi tregtare dhe Shërbimi në Njësinë Administrative Tepelene                           | 7,000          | 30,000        |
| III.2   | Njësi tregtare dhe shërbimi në Njësitë e tjera Administrative                            |                |               |
|         | QENDER                                                                                   | 5,000          | 25,000        |
|         | KURVELESH                                                                                | 5,000          | 25,000        |
|         | LOPES                                                                                    | 3,000          | 25,000        |
| III.3   | Njësi tregtare për tregtim karburanti                                                    | -              | 25,000        |
| III.4   | Njësi prodhimi                                                                           | 10,000         | 30,000        |
| III.4.1 | Njësi prodhimi në Njësinë Administrative Tepelene                                        | 10,000         | 30,000        |
|         | Njësi prodhimi në Njësitë e tjera Administrative                                         | 10,000         | 30,000        |
| III.5   | SUBJEKTE NDËRTIMI                                                                        |                |               |
| III.5.1 | Subjekte ndërtuese për selinë administrative                                             |                | 30,000        |
|         |                                                                                          |                |               |
|         |                                                                                          |                |               |



|       | <b>Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit</b> | <b>Lekë/kantier/vit</b> |                |
|-------|-------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|----------------|
|       | Për vlera investimi deri në 5 000 000 lekë                                                |                         | <b>20,000</b>  |
|       | Për vlera investimi 5 000 001-15 000 000 lekë                                             |                         | <b>30.000</b>  |
|       | Për vlera investimi 15 000 001-25 000 000 lekë                                            |                         | <b>50.000</b>  |
|       | Për vlera investimi 25 000 001 – 50 000 000 lekë                                          |                         | <b>70.000</b>  |
|       | Për vlera investimi 50 000 001 – 100 000 000 lekë                                         |                         | <b>90.000</b>  |
|       | Për vlera investimi 100 000 001 – 200 000 000 lekë                                        |                         | <b>100.000</b> |
|       | Për vlera investimi mbi 200 000 000 lekë                                                  |                         | <b>150.000</b> |
| III.6 | Shoqata, fondacione, ente të ndryshme shtetërore, organizata joqeveritar                  | -                       | <b>0</b>       |
|       | Institucione Administrative Publike                                                       |                         | <b>12,000</b>  |
|       | Organizata të tjera jofitimprurëse                                                        |                         | <b>0</b>       |
| III.7 | PROFESIONE TE LIRA                                                                        |                         |                |
|       | Profesione të lira                                                                        |                         | <b>7,000</b>   |
| III.8 | AMBULANT                                                                                  |                         | <b>2,000</b>   |
|       |                                                                                           |                         |                |
|       |                                                                                           |                         |                |

Baza e tarifës: është vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit. Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit është vjetor. Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi paguhet në këste, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit të pijshëm. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civilepërkatese dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoria II, III. Detyrimi paguhet brenda datë 30 qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR. Kategoria III.5 “Subjekte Ndërtimi” Për “Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit”, llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Tepelene të kërkesës për leje shfrytëzimi. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Tepelene vetëm pasi të kenë paguar detyrimet përkatëse për selinë administrative dhe për “çdo kantier ndërtimi”, para zbardhjes së lejes së ndërtimit si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit. Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Përjashtime për kategoritë e ndryshme:

Tabelë..... Përfjashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e pastrimit

| Përfjashtime                                                                                                                                                        | Niveli        |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| 1 Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)        | 50% të vlerës |
| 2 Përfituesit e ndihmës ekonomike                                                                                                                                   | 0             |
| 3 Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes); Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç); | 50% te vleres |
|                                                                                                                                                                     |               |

- a) Nënkatëgoritë 1-3 përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së pastrimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë sektori tatim taksave dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht: - Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike.
- b) Listat e përfituesve administrohen nga sektori tatim taksave, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor. b) Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.
- c) Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Tepelene; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Tepelene Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Tepelene; Komunitetet fetare të njohura me ligj.
- d) Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës : Për Kategoria I “Familjarët, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, është Ujësjellës Kanalizime sh.a. Tepelene duke përfituar 2% të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa. Kategoria III. “Biznesi”, Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit, është sektori tatim taksave.

## II.2 Tarifa e ndriçimit

Përkufizimi: Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose resident ne Bashkinë Tepelene

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë ..... Tarifë ndriçimi për familje

| I | Tarifë ndriçimi për familje N   | Njesia           | Tarifa |
|---|---------------------------------|------------------|--------|
|   | Njesia administrative Tepelene  | lekë/vit/familje | 500    |
|   | Njesit e tjera administrative : |                  | 0      |



Tabelë ..... Tarifë ndriçimi për institucione

| II | Tarifë ndriçimi për institucione                                                                  | Njesia         | Tarifa |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------|
|    | Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj. dhe ojf. | lekë/vit/njesi | 5,000  |

Tabelë ..... Tarifë ndriçimi për biznesin

| III | B                                                                                        | Njesia         | Bisnes i vogel | Bisnes i madh |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|---------------|
|     | Subjekte tregtare dhe shërbimi, në Njësine Administrative Tepelene, Uji ftohte Tepelene, | lekë/vit/njesi | 5,000          | 7,000         |
|     | Subjekte tregtare dhe shërbimi, në Njësine Administrative                                |                | 1,000          | 3,000         |
|     | Njësi tregtare për tregtim karburanti në Njësine Administrative Tepelene                 |                |                | 5,000         |
|     | Njësi tregtare për tregtim karburantinë Njësitet Administrative :.....                   |                |                | 5,000         |
|     | Profesione të lira Njësine Administrative Tepelene                                       |                | 3,000          |               |
|     | Njësi prodhimi në Njësine Administrative Tepelene                                        |                | 5,000          | 7,000         |
|     | Njësi prodhimi në Njësine Administrative :.....                                          |                | 5,000          | 7,000         |
|     | Subjekte Ndertuese                                                                       |                |                | 8,000         |

Kategoria I. "Familjarët": Detyrimi paguhet në këste, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit të pijshëm. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së ndriçimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë II, III: Detyrimi paguhet brenda datë 30 qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR. Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria

është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës : Për Kategoria I “Familjarët”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit, është Ujësjetillës Kanalizime sh.a Tepelenë, duke përfituar 2% të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa.

Kategoria II. “Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj.dhe OJF” dhe III. “Biznesi”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit është sektori tatim taksave.

Përjashtime për kategoritë e ndryshme:

| Përjashtime                                                                                                                                                          | Niveli        |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| 1 .Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)        | 50% të vlerës |
| 2 .Përfituesit e ndihmës ekonomike                                                                                                                                   | 0             |
| 3. Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes); Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç); | 50% te vleres |
|                                                                                                                                                                      |               |

d) Në Kategorinë “Tarifë ndriçimi për familje” përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç, përveç bashkëshortit/bashkëshortes) Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë sektori tatim taksave dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht: - Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike. Listat e përfituesve administrohen nga sektori tatim taksave, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor.

e) Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.

f) Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Tepelene; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Tepelenë; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Tepelenë; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

### II.3 Tarifa e gjelbrimit

Përkufizimi: Tarifa e gjelbrimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridike , vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Tepelenë.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit, janë të shprehura si më poshtë:



| IV | Tarife gjelberimi per familjare    | Njesia           | Tarifa |
|----|------------------------------------|------------------|--------|
|    | Familje Nj.administrative Tepelene | lekë/vit/familje | 500    |

#### Tarife gjelberimi per institucione

| IV | Tarifë Gjelberimi për institucione                                                                | Njesia         | Tarifa |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------|
|    | Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj. dhe ojf. | lekë/vit/njesi | 5,000  |

#### Tarife gjelberimi per biznesin

| IV   | Tarifë Gjelberimi për institucione               | Njesia         | Tarifa |
|------|--------------------------------------------------|----------------|--------|
| IV.1 | Subjekte tregtare dhe shërbimi                   | lekë/vit/njesi | 5,000  |
|      | Subjekte tregtare dhe shërbimi                   | lekë/vit/njesi |        |
|      | Biznes i Vogël Njësia administrative             | lekë/vit/njesi | 5,000  |
|      | Biznes i Madh Njësia administrative              | lekë/vit/njesi | 8,000  |
| IV.2 | Pikë Karburanti Njësia administrative            | lekë/vit/njesi | 8,000  |
| IV.3 | Profesione të lira, Biznese Njësia administrativ | lekë/vit/njesi | 5,000  |
| IV.4 | Subjekte prodhimi, përpunimi, etj.               | lekë/vit/njesi | 6,000  |
|      | Biznes i Vogël Njësia administrative             | lekë/vit/njesi | 5,000  |
|      | Biznes i madh Njësia administrative              | lekë/vit/njesi | 8,000  |
| IV.5 | Biznes transporti Njësia administrative          | lekë/vit/njesi | 7,000  |
| IV.6 | Subjekte ndërtimi                                | lekë/vit/njesi | 8,000  |

Niveli i tarifës së gjelbrimit: Detyrimi për Tarifën e gjelbrimit është vjetor.

Kategoria I “Familjarët”: Detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së gjelbrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë II, III: Detyrimi paguhet brenda datë 30 qershor. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR.

Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal).

| Përfshirje                                                                                                                                                          | Niveli        |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| 1 Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)        | 50% të vlerës |
| 2 Përfituesit e ndihmës ekonomike                                                                                                                                   | 0             |
| 3 Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes); Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç); | 50% të vlerës |
|                                                                                                                                                                     |               |

a) Kategoria I “Tarifë gjelbrimi për familje” përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së gjelbrimit (vetëm në rastet kur janë kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç, përveç bashkëshortit/bashkëshortes. Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë sektori tatim taksave dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht: - Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike. Listat e përfituesve administrohen nga sektori tatim taksave, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor.

b) Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.

c) Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Tepelenë; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Tepelene; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Tepelenë; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës : Për Kategoria I “Familjarët, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbrimit, është Ujësjiellës Kanalizime Qytet Sh.A, duke përfutur 2% të të ardhurave të arkëtuara nga tarifa. Kategoria II. “Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj.dhe OJF” dhe III. “Biznesi”, struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbrimit është sektori tatim taksave.

## TE SEKSIONI I NDERTIMIT

Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë



· një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Kontrollit të zhvillimit të territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte. Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është sektori i tatim taksave pranë Bashkisë Tepelenë.

#### Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille.

Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose landfillin e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille duhet të mbulojë koston e operimit për trajtimin e këtyre mbetjeve, si dhe koston për mbylljen e kujdesin pas mbylljes së landfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vjetësh.

Bashkia Tepelenë, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe infrastrukturës, dhe Sektori i mjedisit, pyjeve dhe menaxhimit të ujërave, planifikojnë venddepozitimin e përkohshëm ose landfillin e trajtimit të mbetjeve inerte.

Niveli i tarifës: Emërtime Njësia Bashkia Tepelenë

Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në venddepozitimin e perkoheshem lekë/ton/mbetje **500 leke per familjaret**

Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në venddepozitimin e perkoheshem lekë/ton/mbetje **1,000 leke subjektet fizike e juridike.**

Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në venddepozitimin e perkoheshem lekë/ton/mbetje **1,500 leke subjektet ndertuese**

Ky vendim hyne ne fuqi me 03.01.2020

KRYETARI  
Ylli Alika

